

ROLI I AHMET ZOGUT NË KRIJIMIN E REPUBLIKËS SHQIPTARE 1925-
1928

TEMA PËR TITULLIN
MASTER I ARTEVE NË DEPARTAMENTIN E HISTORISË

NGA

ENIS TAHIRI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I HISTORISË
PRISHTINË

TETOR, 2021

EKSPOZE E TEMËS
ROLI I AHMET ZOGUT NË KRIJIMIN E REPUBLIKËS
SHQIPTARE 1925-1928

Mentor:

Prof. Dr. Nuri Bexheti

Kandidati:

Enis Tahiri

Punimi trajton rolin e Ahmet Zogut në çështjen e ndërrimit të statusit të Shqipërisë nga Principata në Republikë. Zogu ishte figurë e njohur në Shqipëri edhe para Luftës së Parë Botërore. Duke qenë pinjoll i një prej familjeve më të njohura të Matit, Zogu shumë shpejt do të bëhej pjesë e proceseve më të rëndësishme politike dhe ushtarake në vend, e megjithatë ngritja më e madhe politike e tij ndodhi pas LIP. Zogu shfrytëzoi kaosin e brendshëm politik në të cilin u gjend Shqipëria pas luftës. Ai me gjithë forcën e tij dhe intrigat politike arriti t'i largoj kundërshtarët politik nga Shqipëria, dhe të siguroj për të dhe përkrahësit e tij të gjitha institucionet e vendit.

Punimi është i ndarë në katër kapituj. Pjesa e parë trajton gjendjen politike në Shqipëri menjëherë pas L.P.B, organizimin e Kongresit të Lushnjës, fillimin e parlamentarizmit shqiptar dhe ngritjen e figurës kyqe të kësaj teme, Ahmet Zogut.

Pjesa e dytë përfshin acarimin e marrëdhënieve në mes pozitës dhe opozitës shqiptare pas zgjedhjeve të viti 1923, që rezultoi me kryengritjen e armatosur të opozitës, e cila e detyroi Zogun dhe përkrahësit e tij të largohen jashtë vendit. Më tutje, trajton çështjen e krijimit të qeverisë nga opozita e bashkuar dhe kthimin e Zogut me anë të forcës, gjë që rezultoi me largimin e të gjithë kundërshtarëve politik të tij nga shteti shqiptar.

Pjesa e tretë përfaqëson çështjen bosht të punimit: rolin e Ahmet Zogut në shpalljen e Shqipërisë Republikë. Në këtë pjesë synohet të hidhet dritë mbi çështjen se pse Zogu vendosi të shpallte Shqipërinë Republikë dhe jo Monarki, me gjithë mundësitë që monarkinë ta bënte punë të kryer që në vitin 1925. Kapitulli përfshin segmente të tjera të rëndësishme siç është ndjekja e kundërshtarëve politik, interesimi i Zogut për çështjen e Kosovës, dhe së fundmi çështjen e Shën Naumit, një nga temat që edhe sot vazhdon të ngjallë debat në mesin e studiuesve.

Pjesa e fundit trajton orientimin e politikës së jashtme të Zogut pas ardhjes në pushtet. Theksi do të bie në marrëveshjet e arritura me italianët mbi një sërë çështjesh siç ishin ato financiare, politike dhe ushtarake.

Duke u mbështetur në shtyllat bartëse të metodologjisë shkencore, specifikisht përdorimit të metodës së përshkrimit, analizës e krahasimit, punimi synon të analizoj ngritjen e figurës së Zogut që nga përfundimi i Luftës së Parë Botërore e deri në shpalljen e Shqipërisë Republikë Parlamentare, e bashkë me të dhe rolin e tij në procesin e demokratizimit dhe konsolidimin e institucioneve në Shqipërinë e periudhës së mes luftrave.